



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
AGJENCIA E TRAJTIMIT TË PRONAVE

RAPORT MONITORIMI
ZBATIMI I PLANIT TË INTEGRITETIT
AGJENCIA E TRAJTIMIT TË PRONAVE
Janar – Qershor 2022



Përmbledhje Ekzekutive

Lufta kundër korrupsionit është prioritet i qeverisë shqiptare. Angazhimi në forcimin e kuadrit institucional, strategjik, ligjor dhe operacional në fushën antikorrupsion ka çuar drejt hartimit, miratimit dhe aplikimit të instrumenteve konkrete kundër korrupsionit me qasje parandaluese dhe ndëshkuese.

Prioritizimi i kuadrit antikorrupsion është jetësuar së fundi nëpërmjet: forcimit të kompetencave dhe kapaciteteve të Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit; koordinimit dhe zbatimit të nismave antikorrupsion të parashikara në Strategjinë Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2015-2023, si edhe të forcimit të kuadrit rregullator dhe të mekanizmave të integritetit në administratën publike.

Mbështetur në dokumentet strategjik të miratuar nga Ministria e Drejtësisë, në cilësinë e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, e cila ka përgjegjësinë kryesore të hartojë politika në luftën kundër korrupsionit dhe të bëjë monitorimin e zbatimit të tyre nga ana e institucioneve publike në vend, stafi i Agjencisë së Trajtimit të Pronave është i vetëdijshëm se duhet t'i shërbej interesit publik, në mënyrë që të gjitha veprimet tona të jenë me integritet të lartë, me vlera etike dhe të bazuara në ligj. Agjencia e Trajtimit të Pronave, në zbatim të VKM nr. 247, datë 20.03.2015 “*Për miratimin e strategjisë ndërsektoriale kundër korrupsionit për periudhën 2015-2023*” i ndryshuar me VKM nr. 516, datë 01.07.2020, ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm në përmirësimin e kornizës rregullatore dhe operationale të integritetit.

Plani i Integritetit të ATP-së është një instrument i luftës kundër korrupsionit, i cili ka të parashikuar masa të identifikuara në 6 fusha të përgjegjësisë institucionale të ATP-së. Plani i Integritetit përmban 13 masa të karakterit rregullator e operacional, dhe për të cilat janë parashikuar ndërhyrje (aktivitete) përkundrejt çdo risku të evidentuar. Afati i zbatimit të këtij Plani Integriteti është deri në vitin 2023.

Në përputhje me kreun 2, pika 2.1 të Planit të Integritetit të Agjencisë së Trajtimit të Pronave, si dhe me Metodologjinë e Monitorimit të Planit të Integritetit për institucionet e qeverisjes qendrore, Agjencia e Trajtimit të Pronave ka hartuar këtë raport monitorimi mbështetur në të dhëna të verifikueshme dhe transparente.

Për periudhën janar - qershor 2022, Plani i Integritetit ka të parashikuar për zbatim 6 masa/aktivitete, të shpërndara në tre objektiva, përkatësisht:

Objektivi 1: Procese dhe rregulla të qarta mbi aspekte të integritetit në ATP – në mënyrë që të minimizohet çënimi i tyre nga risqet e integritetit

Objektivi 2: Burime njerëzore adekuate, të qëndrueshme, të kualifikuara dhe me trajnime të përshtatshme për ti rezistuar shkeljeve të integritetit

Objektivi 3: Transparenca më e lartë e punës dhe e veprimtarisë së ATP-së brenda institucionit, me aktorë të jashtëm të interesuar dhe publikun

Nga monitorimi rezulton se në totalin prej 6 masash (aktivitetesh) të parashikuara për zbatim për periudhën janar - qershor 2022, rezulton se: janë zbatuar 5 masa/aktivitete, në proces zbatimi ka mbetur 1 masë/aktivitet dhe nuk ka masa të pazbatuara.




Tabela e zbatimit

Raporti i monitorimit të zbatimit të Planit të Integritetit të Agjencisë së Trajtit të Pronave, përmban një analizë të përgjithshme mbi aspekte të integritetit në ATP, të performancës institucionale për ti rezistuar shkeljeve të integritetit si dhe çështje të transparencës institucionale në luftën kundër korrupsionit.

Masa	Personi Përgjegjës	Afati i fundit	Veprimet e ndërmarra dhe koha kur janë ndërmarrë	Shtrirja e zbatimit
Objektivi 1: Procese dhe rregulla të qarta mbi aspekte të integritetit në ATP – në mënyrë që të minimizohet cënimi i tyre nga risqet e integritetit				
Reflektimin e strukturës së brendshme institucionale përfshirë edhe njësinë e sinjalizimit apo konfliktit të interesit në Rregulloren e Brendshme të institucionit.	Koordinatori i Integritetit	3m1 2022	Publikimi dhe zbatimi i rregullores për Sinjalizuesit dhe mbrojtjen e sinjalizuesve.	E zbatuar
Përfshirjen e funksioneve/njësive që rrjedhin nga ligje të tjera, si ai për të drejtën e informimit apo njoftimit dhe konsultimit publik (koordinatorët) në Rregulloren e Brendshme të institucionit.	Koordinatori i Integritetit	3m1 2022	Ndryshimi i Rregullores së brendshme duke reflektuar funksionet që rrjedhin nga ligje të tjera	E zbatuar
Përcaktimin e linjave të qarta të komunikimit dhe raportimit ndërmjet drejtorive të ndryshme; komunikimin me institucionin qendror në Rregulloren e Brendshme të institucionit.	Koordinatori i Integritetit	3m1 2022	Ndryshimi i Rregullores së brendshme duke përcaktuar detyrat funksionale të drejtorive të ATP-së dhe bashkërendimin e punës midis tyre.	E zbatuar
Të formalizohet në rregulloren e brendshme të institucionit procesi	Koordinatori i Integritetit	6m1 2022	ATP harton Deklaratën e Përparësive në fillim të vitit	Pjesërisht

i planifikimit vjetor dhe ndërveprimi i njësive të ATP-së në kuadër të këtij procesi.			kalendari ku pëcakton plan performancën për njësitë e institucionit dhe bashkërendimin e punës. Ky proces do të reflektohet kur të ndryshohet rregullorja.	
Objektivi 2: Burime njerëzore adekuate, të qëndrueshme, të kualifikuara dhe me trajnime të përshtatshme për ti rezistuar shkeljeve të integritetit				
Monitorimi në vijimsi i zbatimit të rregullores për Mbrojtjen, perpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhenave personale	Koordinatori i Integritetit	Në vijimsi	Monitorimi në vijimsi i zbatimit të rregullores për Mbrojtjen, perpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhenave personale	E zbatuar
Objektivi 3: Transparenca më e lartë e punës dhe e veprimtarisë së ATP-së brenda institucionit, me aktorë të jashtëm të interesuar dhe publikun				
Zbatimi në vijimsi i procedurës e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe mekanizmat e mbrojtjes së konfidencialitetit.	Koordinatori i Integritetit	Në vijimsi	Zbatimi në vijimsi i procedurës e shqyrtimit të hetimit administrativ të sinjalizimit dhe mekanizmat e mbrojtjes së konfidencialitetit.	E zbatuar

Konkluzione dhe Rekomandime

Ky raport monitorimi është kryer në përputhje me metodologjinë e monitorimit të instrumentit plan integriteti, dhe të hartimit të raportit të monitorimit. Viti 2021, ishte viti i parë i zbatimit të këtij plani integriteti në Agjencinë e Trajtimit të Pronave, vit gjatë të cilit u hasën edhe disa vështirësi që patën ndikimin e tyre mbi ecurinë e zbatimit të tij, sipas parashikimeve të bëra dhe afate konkrete. Një strukturë e re organizative e Agjencisë së Trajtimit të Pronave e miratuar gjatë vitit 2021, ndryshimet referuar strukturës institucionale dhe organikës së institucionit, mjedisit rregullator, partneritetit dhe angazhimit nga ana e të gjithë njësive teknike afektuan zbatimin e plotë të këtij instrumenti.

Pengesat e ardhura edhe si pasojë e pandemisë Covid-19, gjatë vitit 2021, patën gjithashtu ndikimin e tyre në zhvillimin e disa prej aktiviteteve, kryesisht ato të lidhura me aktivitete për forcimin e kapaciteteve të stafit të institucionit. Në këto kushte, ATP ka zhvilluar në formë virtuale aktivitetet dhe trajnimet për forcimin e kapaciteteve njerëzore.

Në përmbyllje të këtij raporti monitorimi për periudhën *janar-qershor 2022*, të gjetjeve që ky dokument na ofron, rezulton se:

- Agjencia e Trajtimit të Pronave ka vijuar me zbatimin e planit të integritetit.
- Sektorët e ATP-së kanë shënuar përparime kryesisht në forcimin e kapaciteteve të stafit, të stafit të ri të rekrutuar, në rishikimin e strukturës dhe në forcimin e integritetit dhe të instrumenteve e mekanizmave rregullatore antikorrupsion.
- Implementimi i strukture së re të Agjencisë së Trajtimit të Pronave, të miratuar me urdhër të Kryeministrit nr.39, date 23.03.2021 "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë së Trajtimit të Pronave ",
- Është rishikuar dhe hartuar Rregullorja e re e brendshme për organizimin dhe mirëfunksionimin e institucionit në përputhje me Planin e Integritetit.
- Garantuar transparencë e plotë dhe ofrim i informacioneve mbi aktivitetin e ATP-së për publikun e gjerë nëpërmjet faqes së internetit www.atp.gov.al.

Hapa të tjera

- Të vijohet me zbatimin e parashikimeve në planin e veprimit;
- Të merren masa nga titullarët që përfaqësimi i institucionit në procese gjyqësore me ish-punonjës të ATP-së të bëhet nga stafi me përvojë në këtë institucion.;
- Të merren masa motivuese për punonjësit, si p.sh. duke ngritur një sistem motivimi të stafit etj.);
- Sektorët të koordinojnë me njëri-tjetrin në hartimin e një planifikimi sa më të saktë vjetor të aktiviteteve (në bazë të analizave të aktiviteteve periodike dhe atyre të paplanifikuara).;
- Në rastet e aktiviteteve të paplanifikuara, të mbahet një procesverbal lidhur me eventin dhe furnitorët, për të arritur në një përdorim sa më efektiv të fondeve.;
- Të realizohen kontrata me çmime preferenciale me agjenci udhëtimesh, duke shmangur apo duke minimizuar kostot e agjencisë (zgjedhja e agjencisë të bëhet nëpërmjet procedurave të tenderimit);
- Të realizohen trajnime të domosdoshme dedikuara zhvillimit të aftësive të GMS-së për kryerjen e funksioneve të tij.
- Realizimi i trajnimeve të dedikuara për funksionin e Koordinatorit të Menaxhimit të Riskut Financiar, me qëllim mbulimin me kompetencë të detyrave funksionale të tij.

